



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.5/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e ankuesit Sha.M., nga Prizreni ndaj Gjyqtarit A.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm- Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur sipas lëndës C.nr.361/2016, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.23.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ankuesit (të paditurit) Sh.M., nga Prizreni, gjyqtarit A.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm- Divizioni Civil.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës Sh.M., në ankesën e tij ka cekur se ka vërejtje të shumta në rrjedhën e procedurës së gjykimit në lëndën civile C.nr.361/2016, të cilën e ka gjykuar gjyqtari A.B.,. Vërejtjet e tij kanë qenë se kontratën e huazimit të avokati Y.K., nuk e ka nënshkruar V.M., (nëna e tij), deklarata e dhënë tek noteri B.L., ku është shtuar një dëshmitare e panjohur, është fiktive, ka parregullsi edhe tek revokimi i prokurës tek noteri nga ana e V.M.,. Gjithashtu V.M., asnjëherë nuk është ftuar në seancë, pala M.K., asnjëherë nuk ka dhënë hua V.M., , ai vet Sh.SM., asnjëherë nuk ka blerë veturë nga M.K., dhe nuk ka marrë hua, por se gjatë viteve 2003 gjer me 2008 nga M.K., ka marrë të holla me fajde të cilat i ka kthyer në vitin 2008. Pala paditëse M.K., në vitin 2008 ka qenë i akuzuar për fajde së bashku me vëllezërit e tij dhe ankuesi Sh.M., ka qenë dëshmitar në këtë çështje për të cilën edhe kanë pasur probleme me vëllezërit e M.K.,. Ndër tjera ka cekur se i gjithë problemi ka qenë për shitblerjen e banesës dhe lokalit afarist i cili ka qenë i blerë me kredi dhe të cilën nuk kanë mundur ta paguajnë dhe në këtë rast me M.K., janë dakorduar që ai të paguajë borxhin në mënyrë që të shlyej borxhin e kredisë në emër të tyre. Të gjitha këto i ka bashkëngjitur si provë në shqyrtim të gjyqtari A.B., i cili nuk i ka marrë parasysh si provë dhe ka vendosur në dobi të palës paditëse M.K.,. Ankuesi pasi që ka pranuar Aktgjykimin nuk ka parashtruar ankesë në shkallën e dytë dhe më pas ka kërkuar nga gjyqtari kthim në gjendje të mëparshme, duke cekur se nuk e ka pranuar aktgjykimin personalisht dhe për këtë nuk ka pasur mundësi të ankohet. Andaj nga të lartcekurat i është drejtuar Këshillit Gjyqësor me kërkesë që të anulohet Aktgjykimi C.nr.361/2016 dhe të iniciohet procedura disiplinore ndaj gjyqtarit A.B.,.

Gjyqtari A.B., në deklaratën e tij të datës 13.03.2023 lidhur me këtë ankesë, ka theksuar se është e vërtetë që ka gjykuar në lëndën civile C.nr.361/2016 për të cilën pala e paditur ka paraqitur

ankesë ndaj tij dhe se në këtë çështje paditës ka qenë M.K., të cilin e ka përfaqësuar av. N.K., , kurse të paditur kanë qenë V.M., dhe Sh.M., të cilët i ka përfaqësuar me autorizim av. V.H.,. Gjyqtari ka cekur se kjo lëndë fillimisht ka qenë te gjyqtari V.T., i cili pasi ka kaluar në Gjykatën e Apelit, lënda i është ndarë atij dhe se ai e ka përfunduar dhe ka marr aktgjykim C.nr.361/2016 me datë 02.10.2019, i cili aktgjykim bëhet i plotfuqishëm dhe arkivohet me datë 10.03.2021. Aktgjykimi iu është eksponuar palëve dhe në mes tjerash edhe të paditurit Sh.M., dhe të autorizuarit të tij av. V.H.,. Më pas pala ka parashtruar kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme me arsyetim se palës së paditur nuk i është dorëzuar aktgjykimi dhe lënda është bërë e plotfuqishme. Në kohën kur pala e ka paraqitur këtë kërkesë lënda ka qenë e arkivuar, gjyqtari e ka nxjerrë lëndën nga arkivi dhe ka refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, pasi që në shkresat e lëndës ekziston flete dorëzimi me të cilën është vërtetuar se aktgjykimin e ka pranuar vet pala Sh.M., personalisht si dhe avokati i tij V.H.,.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka iniciuar hetimet për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes A.B., si dhe ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës dhe pasi ka analizuar pretendimet ankimore, ka konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka pasur bazë për shkelje disiplinore pasi që pretendimet e ankuesit (të paditurit) Sh.M., nuk qëndrojnë për faktin se gjyqtari ka vendosur në kuadër të autorizimeve të tij dhe në bazë të ligjit.

Autoriteti kompetent — kryetarja e gjykatës gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuesit Sh.M., ka vërtetuar se i njëjti ka qenë palë e paditur në çështjen civile C.nr.361/2016, ku paditës ka qenë M.K., dhe lëndën e ka vendosur me aktgjykim gjyqtari A.B.,. Padia fillimisht është parashtruar për vërtetim të pronësisë, duke i propozuar gjykatës të nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit, por më pas gjatë shqyrtimit gjykata ka vendosur sipas detyrës. Për palën paditëse avokat ka qenë N.K., , kurse për palën e paditur avokat V.H.,.

Të gjitha pretendimet e ankuesit të cilat i ka cekur si shkelje disiplinore, autoriteti kompetent konsideron se nuk qëndrojnë sepse kemi të bëjmë me pretendime që hyjnë në kuadër të shkeljeve procedurale dhe jo disiplinore dhe për të cilat shkelje pala e paditur dhe secila palë në procedurë ka pasur të drejtën e ankesës ndaj vendimit, në shkallën e dytë si mjet të rregullt juridik. Pretendimet e ankuesit se nuk e ka pranuar aktgjykimin në mënyrë të rregullt nuk qëndrojnë, pasi që në shkresat e lëndës është e bashkëngjitur flete dërgesa për dorëzim personal me nënshkrim të ankuesit Sh.M., me datë 15.02.2021, ku i njëjti e ka pranuar aktgjykimin në mënyrë të rregullt, gjithashtu aktgjykimin e ka pranuar edhe avokati i tij V.H., me datë 19.01.2021.

Bazuar në të lartcekurat, vendimi i gjyqtarit për refuzimin e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme është i arsyeshëm dhe në lidhje me këtë ankuesi është ankuar edhe në Ministrinë e Drejtësisë me datë 06.12.2022, ku të njëjtit këtë shkresë e kanë përcjellë në Gjykatën Themelore në Prizren dhe kryetarja i është përgjigjur kërkesës së ankuesit Sh.M., në lidhje me pretendimet se nuk e ka pranuar Aktgjykimin dhe kjo shkresë është e bashkëngjitur në shkresat e lëndës me datë 12.12.2022.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.5/2023, me datë 23.03.2023

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.